Ekzaminime vizuale te elementeve te jashtem te rezervuarit dhe observimi i nivelit te ujit tek dhomat e rezervuareve jane pjese e testit te papershkueshmerise. Ekzaminimet vizuale perfshijne percaktimin e vendndodhjes se rrjedhjes se mundshme ne siperfaqen e murit dhe bashkimet si dhe ne percaktimin e ujit ne pajisjet hidraulike dhe ne pusetat grumbulluese te poshtme dhe ne drenazhin perreth. Kjo lejon lokalizimin dhe percaktimin e shkakut per rrjedhjen ne strukture.

Matjet e nivelit te ujit ne dhomat e ujit duhet te zbatohen ne shkallet fikse ne fillim dhe ne fund te periudhes se ekzaminimit. Matjet ne distance duke perdorur nje pike fikse japin nje shtese por jo nje metode matje precize. Avullimi ne dhomat e ujit eshte shume i ulet dhe mund te neglizhohet gjate testit te papershkueshmerise.

Testi i papershkueshmerise quhet i suksesshem ne se plotesohen tre kerkesa:

- Nuk shikohet asnje rrjedhje e ujit jashte siperfaqes.
- Nuk ka zhurma te futjes se ujit .
- Nuk ka ulje te matshme te nivelit te ujit gjate nje testi prej 48 oresh.

Linja do te testohet ne nje presion te urdheruar nga Konsulenti. Konsulenti do te marre ne konsiderate per lartesine e presionit te testit, diferencen e nivelit te tokes pergjate linjes. Presioni ne linje nuk do te rritet deri 24 ore pasi te jete kompletuar mbushja. Presioni do te rritet gradualisht dhe avash deri sa te shkoje tek presioni i kerkuar. Testi do te behet sipas standartit Europian EN 805. Nje protokoll i testeve do te pregatitet.

4.4 HIDRANTET

Hidrantet duhet te sigurojne nje izolim te sigurt te sistemit ndaj rrjedhjeve te ujit dhe nje mirembajtje sa me te vogel. Ato duhet te perballojne goditjet mekanike gjate punes dhe rritjen e presionit qe shkaktojne grushtet hidraulike. Hidrantet duhet te plotesojne kerkesat e projektit te detajuar dhe kerkesat e standartit ISO 9001. Hidrantet duhet te kene nje garanci te certifikuar te pakten deri ne 3 vjet nga prodhuesi i tyre. Cdo Hidrant duhet te jete e shoqeruar me tabelen metalike ku te jepen dimensionet e saj, presioni i punes, etj sipas te dhenave tek Vizatimet Teknike.

Hidrantet duhet te instalohen me ane te bashkimit me flanaxha metalike, guarnicionet plastike perkatese, bullonat dhe vidat duke perdorur pajisjet perkatese te bashkimit te tyre. Ky lloj bashkimi duhet te garantoje nje lidhje te sigurve, homogjene dhe jetegjate. Hidrantet do te jene te tipit nentokesor dhe duhet te mbeshteten tek e ashtuquajtura kembe metalike e cila bashkohet me pjesen e hidrantit me ane te flanaxhave metalike. (shih detajet e dhena ne Vizatimet Teknike).

Specialistet qe do te punojne per bashkimin e tyre duhet te jene te pajisur me certifikaten perkatese per punimet hidraulike.

Te gjitha Hidrantet qe do te instalohen ne objekt duhet te jene te shoqeruar me dokumentacionin teknik perkates te kerkuar nga Standartet e mesiperme si:

- Certifikata e Origjines se mallit nga Prodhuesi i tyre
- Certifikata e Origjines se prodhimit te materialit e shoqeruar me tipin e materialit, llojin dhe te dhenat teknike te pershkruara me siper
- Certifikata e Cilesise ISO 9001/14001 ose ekuivalente
- Certifikata e Testimit nga Prodhuesi i tyre
- Manual teknik te prodhuesit te shoqeruar me manualin e operimit, instalimit, te mirembajtjes si dhe te dhenat teknike te tyre.

Transporti i Hidranteve duhet te behet nga automjete te pershtatshme per transportin e tyre te cilat duhet te jene te te pajisura me mbrojtese anesore me lartesi te pakten $H=0,6$ m.

Ato duhet te jene te vendosur drejt, te mbyllura ne kuti druri te posacme prej prodhuesit dhe te mbuluar me nje mbulesa per mos demtimin e tyre nga rrezet e diellit. Ngarkimi dhe shkarkimi i tyre duhet te behet me kujdes dhe duke shmangur perplasjet e tyre, sforcimet mekanike apo demtime te tjera te cilat do te jene pergjegjesi e vete Kontraktorit. Zona e magazinimit duhet te jete e rrafshet, e paster, pa zhavorre apo gure te mprehte, e rrethuar dhe e mbrojtur. Gjate te gjitha kohes se magazinimit Hidrantet duhet te jene te mbrojtura nga efektet e naftes, vajit, solventeve apo substancave te tjera kimike.

Periudha maksimale e magazinimit te tyre duhet te jete e percaktuar sipas standarteve nga vete prodhuesi. Hidrantet duhet te hiqen nga Magazina dhe te zbulohen nga mbulesa e paketimit te tyre ne nje kohe sa me te shkurter para instalimit te tyre.

Hidrantet duhet te instalohen me ane te bashkimit me flanaxha metalike, guarnicionet plastike perkatese, bullonat dhe vidat duke perdorur pajisjet perkatese te bashkimit te tyre. Ky lloj bashkimi duhet te garantoje nje lidhje te sigurve, homogjene dhe jetegjate.

Cilesia e Instalimit varet ne nje mase te madhe nga personeli qe do te beje kete ngjitje dhe respektimi prej tyre i kerkesave teknike. Per kete arsye, specialistet qe do te punojne per bashkimin e tyre duhet te jene te pajisur me certifikaten perkatese per punimet hidraulike e cila do te vertetoje kualifikimin dhe trajnimin e tyre.

Instalimi i tyre duhet te behet ne kushte te motit normale pa shira, debore, ere dhe ne temperature $-10 - + 40$ grade celsius. Pas perfundimit te Instalimit duhet te behet nje testim

per presionin e punes, rrjedhjet apo probleme te tjera konform Kushteve Teknike te Zbatimit Shqiptare (KTZ -78) dhe ne prezence te Supervizorit te punimeve

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen ne menyre perfekte dhe sipas kerkesave teknike te Supervizorit dhe te projektit.

Nje model qe do te perdoret sebashku me certifikaten e cilesise, certifikaten e origjines, certifikaten e testimit dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per aprovim para se te vendoset ne objekt.

Supervizori mund te beje testime plotesuese per te dhenat fizike - mekanike- termike te tyre, per rrjedhje te mundshme si dhe presionin qe durojne (Presioni i Punes duhet te jete 1.5 here te presionit te punes se tubave dhe konform kushteve te percaktuara ne KTZ - 78).

4.5. MATJA E VOLUMEVE

Matjet do te bazohen ne gjatesine e tubave te instaluara dhe ne numrin e valvolave, Hidranteve, pjeseve lidhese dhe pjeseve speciale qe do te vendosen. Cdo instalim shtese mbi te dhenat e projektit nuk do te paguhet.

4.6. ANALIZA E CMIMIT NJESI

Cmimi njesi per Tubat, Valvolat, Hidrantet dhe pjeset speciale perfshin furnizimin, transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve te nevojshme gjate instalimit te tyre si dhe vendosjen e te gjitha elementeve te tyre ne menyre te persosur dhe testimin qe do ti behet per presionin e punes me te cilen do te punojne.

V – Pusetat

5.1 TE PERGJITHSHME

Pusetat do te jene dhoma ku do te vendosen valvolat, hidrantet, dhe matesat e ujit. Ato duhet te ndertohen ne menyre te tille qe te krijohje kushtet e pershtashme per operimin e pajisjeve qe do te instalohen brenda tyre.

Per sa me siper gjate percaktimit te permasave te tyre duhet te kihen paraysh rregullat e meposhtme:

- ✓ Largesia nga fundi i pusetes deri tek buza e poshtme e gotes ose e flanaxhes te jete jo me pak se 10 cm
- ✓ Largesia nga Flanaxha deri tek muri ne drejtim te aksit duhet te jete jo me pak se 20 cm kurse ne drejtim terthor me aksin jo e pak se 25 cm nga buza e jashtme e flanaxhes
- ✓ Largesia ndermjet dy faqeve te jashtme te dy flanaxhave duhet te jete jo me pak se 40 cm.
- ✓ Per rastet kur ne Pusete instalohen me shume se 2 valvola kontrolli duhet te ruhen normalat qe jepen per cdo valvole ne te gjitha drejtimet

Permasat e Pusetave jane dhene ne vizatimet perkatese per cdo pusete ne funksion te organizimit te valvolave, pjeseve speciale dhe sensoreve qe jane instaluar ne to.

Forma e Pusetave mund te jete drejtkendeshe ose rrethore konform kerkesave te projektit por ne te gjitha rastet e pershtatshme per nje pune normale gjate operimit me valvolat e instaluara ne te.

Gjate rehabilitimit te pusetave ekzsituose duhet te kihet paraysh Valvolat qe do te instalohen ne to (forma, lloji, permasat, sasia, etj) si dhe gjendja ekzistuese e vete pusetave duke bere te mundur ruajtjen e pjeseve qe jane ne gjendje pune.

Valvolat e Kontrollit dhe pjeset speciale rekomandohen te vendosen pasi te kete perfunduar ndertimi i dyshemese se pusetes dhe perpara se te ndertohen muret e saj.

5.2 NDERTIMI I Pusetave dhe MATERIALET E PERDORURA

Kontraktori do te ndertoje pusetat ne pozicionin, vendin dhe Permasat e dhena ne projekt.

Ndertimi i Pusetave duhet te behet sipas nje rradhe te caktuar pune duke filluar nga ndertimi i dyshemese se saj dhe pas instalimit te valvolave dhe pjeseve speciale qe jane parashikuar te vendosen ne te vazhdohet me ndertimin e mureve dhe te mbuleses se pusetes. Te gjitha punimet e mesiperme duhet te behen nen mbikqyrjen e Supervizorit te punimeve.

Perpara fillimit te ndertimit te pusetes duhet te hapet gropa ku do te behen punimet e ndertimit te dyshemese me permasa 10-20 cm me te medha se permasat e pjeses se jashtme te mureve te pusetes. Pasi hapet gropa, toka duhet te pregatitet ne menyre te tille qe te siguroje themele te pershtatshme dhe te qendrueshme. Per kete arsye toka poshte bazamentit te pusetes duhet te ngjeshet. Ne rast se toka nuk siguron nje qendrueshmeri te pranueshme ateherë do te perdoret nje shtrese zhavorri me trashesi me te madhe se 15 cm ose nje shtrese butobetoni C 12/15 me trashesi betoni me te madhe se 10 cm.

Dyshemeja e Pusetave duhet te behet me beton C 12/15 sipas kushteve te dhena ne kapitullin mbi punimet e betonit. Ne rast se pusetat ndertohen ne toka te lageta, trashesia e dyshemese prej betoni e pusetes duhet te jete jo me pak se 12 cm

Muret e pusetave mund te jene prej tulle, guri, bloqe betoni ose betone te parapregatitura ne forme rrethore. Muret me gure ose muret e thata lejohet t endertohen vetem ne toka te thata ku niveli i ujrave nentokesore eshte poshte dyshemese se pusetes.

Gjate ndertimit te mureve duhet te zbatohen rregullat e KTZ 4.5 - 78. Kur muret ndertohen me tulla ose bloqe betoni trashesia e tyre nuk duhet te jete me e vogel se 20 cm. Keto mure duhet te behen me llac cemento dhe te suvatohen ne te dy anet e tyre.

Ne rastet e ndertimit te mureve te pusetave duke perdorur betone te parapregatitura trashesia e tyre nuk duhet te jete me e vogel se 10 cm. Pregatitja dhe ndertimi i ketyre mureve duhet te behet duke patur paraysh kushtet e dhena ne kapitullin mbi Punimet e Betonit.

Ne rast se Pusetat do te ndertohen te tipit rrethor, betonet mund te derdhen ne vend ose te parapregatiten. Ne kete rast muret do te jene formuar nga unaza betoni me lartesi 0,5 - 1,0 m te cilat duhet te lemuara nga te dy anet per te eliminuar suvatimet e tyre. Bashkimet e ketyre unazave duhet te jene te rrafshita, te pastruara dhe te lara me uje para se te montohen ne vend. Ne keto bashkime duhet te vihet llac cemento ose kur ka nivele te larta te ujrave nentokesore te vendosen gomina per ndalimin e ujrave (waterstop). Ne keto raste edhe betonet duhet te behen me materiale shtese hidroizoluese

Ne muret e pusetave duhet te vendosen ganxha prej hekuri te rumbullaket me diameter jo me te vogel se 20 mm dhe ne largesi ndemjet tyre 30 - 40 cm te cilat do te sherbjen si shkalie per hyrjen ne fund te tyre.

Vrimat per kalimin e tubave ne rastin e tokave te thata behet me mur me tulla me llac te dobet. Ne rastin e ndertimit te pusetave ne toka te lageta vrimat mbyllen me qafore speciale plastike hidroizoluese (water stop) ose me argjil te ngjeshur dhe li. Ne cdo rast ndermjet

mureve te pusetes dhe tubit duhet te lihet nje boshlllek prej 1 - 3cm. Hapja e vrimave pas ndertimit te pusetes nuk lejohen

Zona perreth pusetes do te mbushet vetem pasi te kete perfunduar suvatimi i jashtem i mureve te saj. Ne rast se puseta do te jete ne nje rruge te pambaruar, korniza e hekurit dhe kapaku nuk vendosen deri sa te behet asfaltimi i rruges

5.3 HIDROIZOLIMI I PUSETAVE

Pusetat duhet te hidroizolohen ne menyre te tille qe te mos lejohet futja e ujrave nentokesore ne to dhe te sigurohet mbajtja e paster dhe e thate e ambienteve te brendshme te saj.

Hidroizolimi i pusetave ndaj ujrave nentokesore behet ne faqet e jashtme te mureve te pusetes me lluster cemento ose material special hidroizolues sipas kushteve teknike te zbatimit deri ne lartesine 30 cm mbi nivelin maksimal te ujrave nentokesore. Ne rast se pusetat do te ndertohen ne kushte me te veshtira per sa i perket pranise se ujrave duhet te behet hidroizolimi i tyre ne te gjitha siperfaqen e jashtme me material special hidroizolues i cili duhet te perdoret sipas instruksioneve te dhena nga prodhuesi dhe te aprovet paraprakisht nga Supervizori i punimeve.

5.4. MBULIMI DHE KAPAKET

Mbulimi i pusetave do te behet me soleta betonarmeje sipas permasave dhe llogaritjeve te bera nga projektuesi. Ato do te vendosen mbi muret e pusetave e drejtimin e dhene nga projektuesi megjithese rekomandohet qe te mbeshteten ne muret qe nuk kane hyrje ose dalje te tubacioneve kryesore. Ne keto soleta do te vendosen **kapake prej gize ne perputhje me EN 124**. Ne rastin kur keto kapake jane te vendosur ne siperfaqe rruge automobilistike atehere ato duhet te jene sipas standardit EN 124 D 400. Ndersa ne rastin e mungeses se ngarkeses se automjeteve atehere kapaku duhet te jete sipas standardit EN 124 A 15.

Ne rast se Valvolat e instaluara ne pusete jane te tipit me volant, kapaket e gizes do te jene te tipit rrethore me diameter jo me pak se 60 cm ne menyre qe te lejohet hyrja e njerezve ne pusete (shih detajet e dhena ne vizatime). Keto kapake duhet te jene te kapur me cerniera speciale me mbulesen prej betoni te pusetes ne menyre te tille qe te mos behet heqja apo shkeputja e tyre nga puseta.

Ne rast se Valvolat e instaluara ne pusete jane te tipit me shpindel kapaket e gizes do te jene ne forme konike me permasat e dhena ne vizatimet perkatese ne menyre qe te lejohet komandimi i te gjitha valvolave qe ndodhen ne pusete nga siper me ane te shpindela perkates. Keto kapake duhet te jene te kapur me cerniera speciale me mbulesen prej betoni te pusetes ne menyre te tille qe te mos behet heqja apo shkeputja e tyre nga puseta por te lejohet levizja e tyre gjate punes se komandimit te valvolave. Detajet e tyre jepen ne vizatimet perkatese.

Kapaket e pusetave ne rruget e asfaltuara duhet te vendosen rrafsh me siperfaqen, ne rruget me kalldrem duhet te vendosen me lart se siperfaqja e rruges por jo me shume se 2 cm, ne rruget e pashtruara duhet te jete me lart se siperfaqja e rruges por jo me shume se 3 cm dhe ne tokat bujqesore duhet te jene 20 - 40 cm mbi siperfaqen e tokes.

5.5 MATJET

Matjet do te bazohen ne numrin e pusetave te ndertuara. Matjet per cdo pusete do te behen ne baze te volumeve te punimeve per germimin e gropes, ndertimin e dyshemese, mureve, soletes dhe armaturave perkatese konform permasave te dhena ne projekt. Cdo punim shtese mbi te dhenat e projektit nuk do te paguhet.

5.6. ANALIZA E CMIMIT NJESI PER PUSETAT

Cmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin dhe vendosjen e te gjitha elementeve te betonit (inertet, uji, cemento, etj) forcimin e bazamentit te pusetes, ndertimin e mureve te pusetes

dhe suvatimin e tyre sebashku me armaturat perkatese, ndertimin dhe vendosjen e soletes se pusetes si dhe sheshimin e siperfaqes perreth pusetes, ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve te nevojshme gjate ndertimit te saj, etj.

Ne kete cmim njesi nuk perfshihet kostoja per germimin e gropes si dhe cmimi njesi per furnizimin dhe vendosjen e Valvolave dhe pjeseve te tjera speciale te cilat jane parashikuar ne zerat e tjere te punimeve.

PREVENTIVI & VLERESIMI I KOSTOS

Hyrje

1. Objektivat e Tabelave te Preventivit te punimeve jane:
 - (a) Te sigurojne informacionin e duhur mbi sasite e punimeve qe duhet te kryhen sipas kesaj oferte ne menyre qe punimet te kryhen me eficence dhe siguri;
 - (b) Te siguroje nje preventiv me cmime te perdoreshme gjate periudhes qe do te kryhen punimet kur Kontrata te kete hyre ne fuqi.

Me qellim qe te arrihen objektivat e mesiperme, Tabelat jane te ndara ne zera dhe te japin detaje te duhura per te bere dallimet ndermjet klasave te punimeve ne menyre te tille qe te jepen konsideratat e duhura te koston se punimeve. Ne lidhje me keto kerkesa, permbajtja e ketyre tabelave eshte e thjeshte dhe pershkrimet jane sa me te shkurtra qe eshte e mundur.

2. Tabelat do te lexohen te lidhur ngushte me Instruksionet per Ofertuesit, Kushtet e Kontrates, Specifikimet Teknike dhe Vizatimet.
3. Sasite ne tabelat jane dhene ne menyre te tille qe te sigurojne nje baze te duhur per oferten. Pagesat do te behen ne baze te punes faktike te kryer per te arritur qellimin e duhur, te matur nga Kontraktori dhe te kontrolluar nga Klienti. Keto pagesa do te behen edhe ne baze te cmimeve njesi dhe vlerave te dhena ne preventivin me cmime.
4. Cmimet njesi dhe vlerat e tjera te dhena ne preventivin me cmime perfshijne sipas Kontrates te gjitha shpenzimet e impiantave te ndertimit, punetoreve, materialeve, kontrollit te punimeve, mirembajtjen, shpenzimet shtese te Kontraktorit, sigurimet e punonjesve, taksat (pervec TVSH e cila eshte e dhene me vete ne masen 20 %), si dhe te gjitha rrisqet dhe obligimet e tjera te kerkuara ne Kontrate.
5. Cmimet njesi dhe vlerat do te futen per cdo ze te dhene ne preventiv edhe ne rastet kur nuk jane dhene sasite e punimeve. Kosto e zerave per te cilat Kontraktori nuk ka future cmime njesi do te mbulohen nga cmimet e tjera te dhena ne preventiv.
6. Kosto e plote per perfundimin e Kontrates do te perfshije koston e zbatimit te gjitha zerave te dhena ne preventivin me cmime dhe per punime te paparashikuara do te perdoren cmime dhe analiza per zera qe korespondojne me punime te peraferta te dhena ne kete preventiv.
7. Drejtimet e pergjithshme dhe pershkrimi i punimeve dhe materialeve nuk eshte e nevojshme te perseriten ne shumatoren e preventivit. Referencat per seksione te vecanta te dokumentacionit te Kontrates do te behen perpara futjes se cmimeve per cdo ze ne preventivin e dhene.
8. Metoda e matjeve per punime te kompletura per pagese do te jete sipas Kushteve te Kontrates.

9. Gabimet do te korrektohen nga Punedhenesi, per ndonje gabim arithmetik te veprimeve te shumezimit dhe mbledhjes si me poshte:
- Kur ka ndryshime ndermjet sasise dhe shprehjes ne fjale do te merret per baze shprehja ne fjale.
 - Kur ka ndryshime ndermjet cmimit njesi dhe vleres totale te nxjerre nga veprimet me cmimin njesi do te merret per baze cmimi njesi dhe sasia e dhene qe eshte e mjaftueshme sipas llogjikes se Punedhenesit.
10. Njesite e matjeve te perdorura ne kete preventiv jane:

i. Njesia matese	Shkrutimi i perdorur
ii. – Meter kub	m ³
iii. - kilogram	kg
iv. - meter	m
v. - ton	t
vi. - milimetri	mm
vii. – muaj	mon
viii. – numer	nr
ix. – meter katror	m ²

11. Sasite totale te perfshira ne matjet perfundimtare per cdo ze do te maten me afersi relative deri ne masen e dhene ne Preventiv.
12. Per qellime te permiresimit te punes se kryer dhe Kontrates, ne preventiv eshte perfshire nje pjese e vecante per punime te paparashikuara e cila do te perdoret me aprovim te Klientit.

Specifikimet e tubit te celikut dhe te rakorderive prej celiku

- Tubi duhet te prodhohet sipas:
Me saldimit ne gjatesi ne anen e brendshme dhe nga jashte te formoje nje rrip karboni, me ane te procesit automatik te saldimit me hark- metalik te zhytur dhe saldimit te puthitur periferik the kjo te formoje si brenda dhe jashte nje kurriz me te njejtin proces ne gjatesine standarte te tubit me nje maksimum prej 5 saldimeve periferike ose duke rrotulluar nje rrip, tabak llamarine ose pllake ne menyre qe te formohet nje tegel spiral perreth perimetrit te tubit. Spiralja e tegelit duhet te saldohet me perputhje si nga ana e brendshme ashtu edhe nga ajo e jashtme me ane te nje procesi saldimit automatik me hark – metalik.
- Tubat dhe rakorderite prej celiku duhet te prodhohen prej pllaka celiku karboni sipas standartit ST360 te ISO 559, ose ekuivalent me minimum tensioni ne jepje prej 225 N/mm² e pershtatshme per minimumin e presionit te punes PN 10.
- Trashesia minimale e pllakes se celikut per tubat te cilat i korrespondojne diametrit nominal te ndryshem duhet te specifikohet ne ENV 10220:1993, ose ekuivalent.
- Tubat e celikut qe do te shtrohen nen toke duhet qe te jene te veshur ne anen e jashtme me material mbrojtës PE sipas standartit DIN 30670 N n blu, me funde me pjerrsi 30 +5/-0° me tapa plastike, me certifikate inspektimi sipas standartit DIN 50049/3.1 B/ EN 10204, ST 37, L = 12 m +/- 500 mm.

TUBA DHE PJESE POLIETILENI ME DENSITET TE LARTE (HDPE)

TE PERGJITHSHME

Te gjitha tuba HDPE dhe pjeset duhet te prodhohen nga nje prodhues marke e njohur e cila duhet te jene ne perputhje me procedurat e sigurimit te cilesise certifikuar ne perputhje me SR EN ISO 9001.

Te gjitha tubat duhet te jene prej materiali PE 100 (17 SDR, PN 10 ose SDR 11, PN 16) ne perputhje me

PAS 1075-Tipi 2 dhe ne perputhje me DIN 8075/8074 dhe DIN EN 12201 dhe DWGW GW 335 pjesa A2 me 90 % te trashesise se tubit ngjyre e zeze dhe me shtrese te jashtme te integruar 10 % ngjyre blu per te identifikuar demtimin e tubit .

Shenimi i gypave do te behet me laser 128 C. Shkrimet duhet te jene te printuar (gdhendur) direkt

ne siperfaqen tubit. Shkrimi me lazer direkt ne siperfaqen e tubit duhet te jete me rezistence te larte dhe nuk dihet te fshihet nga additive agresive te ndryshem.

Te gjitha tubat HDPE do te furnizohen nga prodhues te certifikuar sipas PAS 1075.

Tuba qe do te perdoren ne kete Kontrate do te dorezohet ne spirale per dimensione deri ne OD 50 mm dhe ne tuba te drejte (shufra) per dimensione \geq OD 63 mm .Gjatesia e tubacioneve spirale nuk duhet te kaloje 100 m. Skajet e tubit duhet te jene te mbyllura per te ruajtur tubin qe te mos futen papasterti.

Diametri minimal i rrethit per tubat spiral duhet te jete i tille qe te pengoje tubin nga perdredhja.

Diametri minimal i brendshem i rrethit nuk duhet te jete me pak se 24 here diametri i jashtem i tubit por jo me pak se 60 cm.

BASHKIMI DHE PJESET LIDHESE

Te gjitha tubat HDPE dhe pjeset lidhese do te bashkohen me saldimit me elektrofuzion.

Kontraktuesi duhet te ofroje pjese lidhese te perbera prej polietilene me densitet te larte per saldimit me elektrofuzion.Çdo lloj saldimit apo bashkimi tjeter nuk eshte i pranuar.

Pjeset me elektrofuzion per perdorim per uje te pijshem duhet te jene ne perputhje me dispozitat perkatese ISO 12176-2: 2000. Makina e saldimit me elektrofuzion do te kete nje kontroll kompjuterik per te gjitha hapat e saldimit deri ne fund te ciklit ,duke siguruar lehtesi ne te dhenat perkatese te saldimit, duke ju pershtatur temperatures se jashtme ne Kohen qe duhet per saldimit deri ne fund te ciklit.

Procedura e kontrollit te cilesise duhet te jete ne perputhje me kerkesat e DIN / ISO 9002.

INSTALIMI I TUBAVE (HDPE)

Çdo tub ose komponent do te inspektohet me sy per te siguruar se nuk ka pesuar asnje perpara se te behet instalimi ne kanal.Ndreqja e tubave dhe pjeseve te demtuara do te zgjidhet ne konsultim me perfaqesuesin e punedhenesit.

Kur ndryshimi drejtimit te tubit ne nje nuk mund te behet sipas vlerave te lejuara te devijimit atehere duhet patjeter te perdoren brylat(kthesat) .

Ne asnje rast,rrezja e pranueshme e ktheses nuk duhet te jete me pak se 25 here dimensionin i jashtem i tubit ose sipas rekomandimit i prodhuesit, cilado qe eshte me e madhe.

Kontraktuesi duhet te siguroje te gjitha personelin e nevojshem, pajisjet dhe materialet.

Kontraktuesi duhet te mbikeqyre terrenin, saldatorët dhe punen e tyre gjate gjithë kohës së punimeve. Per kete qellim, kontraktuesi duhet te perdore nje specialist i kualifikuar dhe certifikuar per saldimitin e tubave dhe pjeseve me elektrofuzion.

Çertifikatat saldatoreve duhet te dorezohet tek inxhinieri i zbatimit.

Vetem saldatoret e afte dhe te certifikuar do te lejohen te bejne saldimit e tubave dhe pjeseve lidhese.

Para fillimit te saldimit,saldatoret qe do te bejne ngjitjet do te kualifikohen per procedurat perkatese qe duhet te ndjekin per te bere nje saldim sipas standarteve te lejuara.

Siperfaqet te cilat do te ngjiten duhet te jene te pastra vajrat ,grasot apo nga ndotje te tjera ,me qellim per te shmangur perkeqesimin e cilesise se ngjitjes.

Saldimi do te pezullohet nga kontraktori kur kushtet e motit nuk jane te pershtatshem(psh shi ose stuhi, etj) dhe demtojne cilesine e punes.

Dridhjet ne afersi te makines se saldimit jane te ndaluara gjate procesit te saldimit.

Pas saldimit, ngjitja do te kontrollohet me sy. Ne rast te ndonje mosperputhje me parametrat e saldimit si me poshte tubi do te pritet dhe do te saldohet perseri.

- Indikatorët e saldimit te ndryshem ne lartesi.
- Indikator i saldimit teper i ngushte dhe shume i gjate.
- Indikator i saldimit shume i vogel,
- Krisje ne qender tek indikatorët e saldimit.
- Distance shume e larte (10% e trashesise se tubit eshte e lejuar).

Pas ngjeshjes se shtreses se pare te materialit mbushes ne kanal,duhet te vendoset shiriti sinjalizues pergjate kanalit per te bere identifikimin dhe gjurmimin e tubit.Tek shiriti sinjalizues duhet te jete shkruar ne shqip "Kujdes linje ujesjellesi" .Mostrat e e shiritit sinjalizues do te dorezohen tek Inxhinieri per miratimin e tij.

TESTET PAS DOREZIMIT

Mostrat e tubave HDPE do te merret ne menyre te rastesishme ose sipas udhezimeve nga Inxhinieri.

Inxhinieri mund te kryeje teste te tjera te cilesise dhe te gjitha testet per mostrat e marra per testim.

- Tubat do te jene subjekt i testimit te cilesise ne perputhje me DVGW W 335 (Pjesa 2) dhe sipas PAS 1075 nga nje institur certifikimi i pavarur ne vendet anetare te bashkimit Europian.
- Inspektimi vizual i siperfaqeve te brendshme dhe te jashtme te tubave duke perfshire testet e dimensiot.

Kontraktuesi duhet te perfshije me oferten e tij te gjitha informatat ne lidhje me tuba HDPE ,te dhenat teknike,katalogje.

RUAJTJA E MATERIALEVE

Te gjitha tubacionet duhet te ruhen ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit, ne menyre qe te ruajne cilesine dhe gjendjen e tyre me standardet e percaktuara ne specifikimet teknike.

Tuba dhe pjeset do te ruhen ngritur nga toka dhe do te mbeshteten me kujdes per te ruajtur qendrueshmerine.

Tuba nuk duhet te pushojne direkt mbi njeri-tjetrin por duhet te jene te vendosura dhe te ndara ne paleta prej druri.Per te ruajtur tubat nga deformimi nuk duhet te vendosen me shume se kater tuba mbi njeri tjetrin per cdo palet, ose dy tuba ne rastin e tubave te medha se OD 500 mm.

Bashkuesit dhe zgjatuesit (dhe te gjitha komponentet e tyre) dhe sende te tjera te ngjashme do te ruhen ne kushtet e thata, e ngritur nga toka dhe ne zonat te mbuluara.

Zonat e magazinimit duhet te vendosen me kujdes per te lehtesuar shkarkimin, ngarkimin dhe kontrollin e materiale me dergesa te ndryshme te shenuara ndaras per ti identifikuar me lehtesi.

Tapat e tubave qe vendosen per mbrojtjet e futjes se papastertive ne tu nuk nuk do te hiqet deri ne momentin e instalimit.

INSPEKTIMI I TUBAVE DHE PJESEVE LIDHESE

Para instalimit të tubacionit dhe pjesëve lidhëse në kanal secili tub dhe pjesë duhet të kontrollohet me kujdes nëse ka ndonjë dëmtim.

Tubat dhe pjesët e dëmtuara, të cilat sipas mendimit të Inxhinierit nuk mund riparohen nuk do të lejohet të instalohen.

Inxhinieri në çdo rast ka të drejtë të kërkojë testimin e materialeve.

Testimi do të përballohet nga Kontraktuesi.

PRERJE E TUBAVE

Tubat duhet të priten në përputhje me rekomandimet e prodhuesit, me një metodë, e cila siguron një profil të pastër me kënd të drejtë, pa ndarje apo thyerje të trashësisë së murit të tubave e cila shkakton dëme minimale në çdo shtresë mbrojtëse. Kur është e nevojshme përja, atëherë skajet e tubit duhet të pastrohen me geryes për të mos penguar saldimit.

PJESËT E SALDIMIT ME ELEKTROFUSION

TE PERGJITHSHME

Pjesët e saldimit me elektrofuzion me siguri të lartë do të jenë prej materiali HDPE 100 për lidhjen e tubave të ujit të pijshëm nga HDPE 100 SDR 11 ose SDR 17 për presionet operative deri në 16 bar, dhe duhet të jenë në përputhje me EN1555-3, EN12201-01: 2003 dhe EN12201-02:2003, DIN 8074 dhe DIN 8075.

Rezistenca spirale e ngrohjes duhet të jetë e ekspozuar, pa shtresë mbrojtëse PE dhe e ngulitur mirë në trupin e pjesës, për transferim simetrik ideal të nxehtësisë gjatë shkrijës, thellesia e madhe e hyrjes, zona të gjera bashkimi dhe zona së ftohta, për përdorimin pa paisje mbajtëse gjatë kohës së saldimit.

Pjesët e saldimit me elektrofuzion duhet të kenë indikator të shkrijës për kontroll vizual dhe për kontrollin zonave ekstra-të gjera të ftohta në skaje dhe në mes për të ndihmuar përshtatjen e tubit dhe për të parandaluar rrjedhjen e materialit të shkrire.

Pjesët me elektrofuzion nga DN 450 deri në DN 630 do të jenë me teknologjinë para-ngrohje për optimizimin e hapësirave midis bashkuesit dhe tubit si pasojë e ovalitetit të tubit.

Të gjitha pajisjet me elektrofuzion duhet të pajisen në fabrike me një barkodë plastik të përshkruar për të për të aplikuar saldimit në përputhje me ISO 13950. Barkodi duhet të përmbajë të dhënat për bashkim dhe gjurmimin e të dhënave, kohën e ftohjes, dimension dhe të dhënat e saldimit. Barkodi do të lejojë gjurmimin automatik në pajisje.

Pajisjet që do të përdoren për saldimit të pjesëve me elektrofuzion duhet të jenë të pajisur me kompensimin e temperaturës sipas ISO 13950 (rregullim automatik i kohës shkrijës sipas kushteve përreth dhe për këto arsye duke siguruar energji të saktë në saldimit).

Të gjitha pajisjet elektro bashkim do të jenë të paketuara individualisht në qese plastike transparente të pajisura me emërtim duke përfshirë të dhënat për llojin e produktit, dimension, materiale, normat ndërkombëtare dhe origjinën e prodhimit.

Të gjitha pjesët me elektrofuzion do të jenë me përdorim të tensionit të ulët gjatë përpunimit.

Të gjitha pjesët me elektrofuzion, pas prodhimit do të jenë të gjurmueshëm me anë të barkodit, nëse certifikate e pranimit sipas DIN EN 10 204 - 3.1 do të kërkojë nga Inxhinieri.

-Rregjistrimi DVGW për VP 607, GW335 - B2

-Me rezistencë ngrohje të ekspozuar për transferimin e nxehtësisë optimale

-Thellesia e futjes e madhe

-Zone e gjere shkrije dhe zonate gjera te ftohjes ne fund dhe ne zonen e tranzicionit ne mes

-Fundi i bronzit i ankoruar ne menyre te perhershme ne HD-PE per pjeset transit.

-E pershtatshme per instalimin pjesëve për uji të pijshëm

SALDIMI (BASHKIMI) ME ELEKTROFUZION

Pjeset e saldimit me elektrofuzion bashkuesit, reduksionet, fashetat, ti dhe berylat duhet te prodhohen nga materiale polietileni (PE 100) PN16me ngjyre te zeze dhe ne perputhje me EN1555-3, EN12201-01:2003 dhe EN12201-02:2003, DIN 8074 dhe DIN 8075 ; dhe duhet te instalohen ne perputhje me kerkesat dhe udhezimet e prodhuesit duke perdorur pajisje te pershtatshme saldimit.

Dizajni i lidhjes , kufizimet dhe procedurat e bashkimit te prodhuesit duhet te respektohen.

Mjetet dhe komponentet e nevojshme per te instaluar bashkimet duhet te jene ne perputhje me praktikat me te mira te instalimit dhe rekomandimet e prodhuesit te gjitha ne perputhje me standatin EN12201 per bashkimin me elektrofuzion per pjeset prej polietileni.

Megjithate, lidhjet ne terren do te kontrollohet dhe jane pergjegjesi e instaluesit ne terren dhe do te kryhet nen mbikeqyrjen e personelit me pervojete, te certifikuar nga prodhuesi (deshmia e kualifikimit te personelit do te ofrohet nga prodhuesi (furnitori) me pajisjet e duhura.

FASHETAT ME VETESHPIM NEN PRESION PER TUBAT HDPE

- Per lidhjet shtepiake OD20 ne OD32 pa valvul sherbimi te integruar.
- Per lidhjet shtepiake OD63 me valvul sherbimi te integruar.

FASHETAT PER SHPIM NEN PRESION ME SHPUES TE INTEGRUAR NE TRUP DHE ME DALJE TE GJATE.**KARAKTERISTIKAT:**

- Projektim kompakt per injeksion solid e formuar si nje pjese e plote.
- Rezistence te ekspozuar te integruar ne trup per transferim te drejtperdrejte te nxehtesise per shkrirjen e tubit dhe te pjeses.
- Kompensimi i temperatures (koha shkrirjes rregullohet automatikisht me temperaturen e ambientit)
- Barcodi lejon gjurmueshmerine automatike te pjeses.
- Elementet e fiksimin per saldimit mund te instalohen pa pasur nevojte per mjete te posaçme.
- Mekanizmi shpues i bere prej metali rezistent korrozioni:
- Mbyllje e perkohshme poshte.
- Muk lejon kercimin e mekanizmit shpues.
- Mekanizem shpues, moment i ulet rrotullues per shpim te shpejte, shpimi i lehte edhe per dimensione te medha.
- Shpimi absolutisht i lehte.
- Mundesi shpimi per rrjedhje nen presion deri ne 16 bar (uje) pa mjete shtese.
- Ndalues metalik i sigurte nga poshte duke siguruar gjatesine maksimale per shpim te sigurte dhe kthimi ne baze.
- Gjatesia e daljes (lidhjes shtepiake) e projektuar per 2 procese saldimit.
- Dalja e pergatitur per te pasur akses me valvul.
- Certifikata e pranimit DIN EN 10 204 - 3.1 ne baze te kerkeses
- Certifikate regjistrimi DVGW per VP 607, GW335 - B2

FASHETAT ME VALVUL SHERBIMI PER SHPIM NEN PRESION ME SHPUES TE INTEGRUAR NE TRUP DHE ME DALJE TE GJATE**KARAKTERISTIKAT:**

- Projektim kompakt per injeksion solid e formuar si nje pjese e plote.
- Trupi i fashetes i perbere nga PE-100.
- Shpues çeliku.
- I rezistueshem nga korrozioni.
- Valvula mund te hapet / mbyllet plotesisht me vetem 10 rrotullime.
- Shpuesi, valvula dhe boshti te bere nga material çeliku rezistent nga korrozioni.

- Mekanizmi shpues, moment i ulet rrotullues per shpim te shpejte, shpimi i lehte edhe per dimensione te medha.
- Mundesi shpimi per rrjedhje nen presion deri ne 16 bar (uje) pa mjete shtese
- Sistemi izolimit te trefishte per vulosjen e brendshme ne lidhje me lidhjen e shtepise.
- Sistemi nenshkrimin e trefishte per vulosjen e jashtme ne lidhje me zonen e instalimit.
- Ndalues metalik i sigurte nga poshte duke siguruar gjatesine maksimale per shpim te sigurte dhe kthimi ne baze.
- Ndalesa siperme dhe e poshtme e fiksuar ne > 150 Nm
- Jo pajisje te jashtme shtese.
- Unaza kruese ne kalimin e boshtit pengon papastertite hyjne ne zonen nenshkrimin.
- Rezistence te ekspozuar te integruar ne trup per transferim te drejtperdrejte te nxehtesise per shkrijen e tubit dhe te pjeses.
- Kompensimi i temperatures (koha shkrijes rregullohet automatikisht me temperaturen e ambientit)
- Barkodi lejon gjurmueshmerine automatike te pjeses.
- Gjatesia e daljes (lidhjes shtepiake) e projektuar per 2 procese saldimit.
- Teleskop EBS i pershtatur posaçerisht per DAV.
- Çertifikata e pranimit DIN EN 10 204 - 3.1 ne baze te kerkeses
- Çertifikate regjistrimi DVGW per VP 610, GW336 per ujin

PROCEDURAT E PERGJITHSHME TE SALDIMIT

Fundi dhe siperfaqja e tubit qe do te saldohen duhet te jene te pastra nga shtesa oksidimit, e thate dhe pa defekte siperfaqesore para se te behet saldimit.

1. Pastrohen papastertite tubi dhe pjesa ne zonen ku do te behet saldimit.
2. Tubat e parregullt ovale qe kalojne 1.5% te diametrit te jashtem apo > 3.0 mm, duhet te sillen ne formen rrethore ne zonen e saldimit nga paisje te vecanta.
3. Pastrohet shtresa e oksidimit nga tubi ne pjesen ku do te behet saldimit.
4. Pastrohet zona ku do te behet saldimit me agjent special pastrimi, akoli prej se paku 99,8% alkool sipas DVGW-VP 603.
5. Behen serish shenimet e distancave per zonat e skrrijes.
6. Shikohet nese cdo gje eshte ne pozicion te rregullt
7. Sigurimi tensionit te tubit me pjesen para saldimit.
8. Lexoni parametrat e saldimit ne barkod.
9. Vazhdo saldimin.
10. Vezhgoni kohen e ftohjes

Ing. Burhan HAFIZI



SPECIFIKIMET TEKNIKE ELEKTRIKE

Me poshte po paraqesim materialet e propozuara ne preventivin e projektit. Materialet e perdorura duhet te jene te reja ne perputhjet me normat ISO,IEC,EN mallrat nga Europo,USA,Japonia , jane perpareore por dhe nga vendet e tjera jane te pranueshme me kusht qe te jene te barasvlereshme me specifikimet teknike dhe plotesimin e standarteve te mesiper.

Duke ju referuar renditjes ne preventiv po paraqesim specifikimet per materialet e perdorura si me poshte :

OBJEKTI : UJESJELLES I QYTETIT RUBIK

Kablo te tensionit ulet 0.4kV.




Tipi FG7OR-0./1kV

-Materiali i perciellsit	baker
-Natyra e perciellsit	fleksibel
-Materiali izolues	Gome EPR
-Forma e perciellesit	Rrethor
-Tensioni nominal U_0/U	0,6/1kV
-Veshja e jashteme	PVC
-Numuri i dejeve	1- 4
-Seksioni	1,5,2,5,4,25,50 mm ²

Kabello 0.6kV TU 4 polar

Formacione a' x mm'	D indikator cmilitore mm	Spesore medio beteste mm	Spesore medio gabos mm	D max entreso mm	Renditeza elektrike max a 20°C Ω/lin	Pesa indikator mm kg/ton	Rendite di rrezate (R)					
							In aria a 30° C	In tubo in odo a 18° C	Intenzito a 20° C		tubo intenzito a 20° C	
									K=1	K=1,5	K=1	K=1,5
4 x 1,5	1,5	0,7	1,8	13,4	13,3	205	23	19,5	29	25	20	19
4 x 2,5	2,0	0,7	1,8	14,6	7,98	260	32	26	37	33	26	25
4 x 4	2,5	0,7	1,8	16,0	4,96	330	42	35	48	42	34	33
4 x 6	3,05	0,7	1,8	17,5	3,30	440	54	44	60	52	43	41
4 x 10	4,0	0,7	1,8	19,8	1,91	640	75	60	79	70	60	56
4 x 16	5,0	0,7	1,8	22,4	1,21	900	100	80	103	91	78	74
4 x 25	5,9	0,9	1,8	26,8	0,78	1300	127	105	133	117	104	97
3x35+25	7,3/5,9	0,9/0,9	1,8	29,2	0,554/0,780	1650	158	128	159	140	125	117
3x50+25	8,7/5,9	1,0/0,9	1,8	32,4	0,385/0,780	2200	192	154	187	164	151	140
3x70+35	10,5/7,3	1,1/1,0	1,9	37,0	0,272/0,554	3000	246	191	229	201	190	175
3x95+50	12,0/8,7	1,1/1,0	2,1	42,0	0,206/0,386	3900	298	233	274	241	231	211
3x120+70	13,7/10,5	1,2/1,1	2,2	46,9	0,161/0,272	4700	346	258	312	274	265	242
3x150+95	16,5/12,0	1,4/1,1	2,4	52,5	0,125/0,206	6300	399	300	348	306	300	272

Tub PE per vendosje kabli



-Materjali Poletilen me densitet te larte

-Ngjyra e kuqe

- Strukturat,tubi duhet te jete i ndertuar me dy shtresa me qendrushmeri te larte mekanike si dhe elementeve kimike .Pjesa e jashteme duhet te jete e brinjzuar per rritjen e fortesis se tubit ndersa pjesa e brendeshme e lemuar qe te lehtesoje levizjen e perciellesave Brenda tubit

- Përdorim për mbrojtjen e kabllave elektrik të tensionit ulët dhe të mesëm si dhe për kabllot e telefonisë.

Në tabelën poshtë jepen diametrit jashtëm dhe i brendshëm i tubave :

D/d mm	20/16	25/21	30/25	40/31	50/39	63/50	75/63	90/76	110/92
--------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	--------


Tubat duhet të plotësojnë normat CEI EN 50086-2-4

2.7.Sistemi mbrojtjes kundër rrufeve dhe i tokezimit.

Përbëhet nga pjesët bakri 1x35, elektroda tokezimi çeliku me gjatësi 1,5 m dhe trashësi 5mm si dhe shirit çelik i zinguar në të njëjtë 30x3mm dhe nga materialet ndihmëse që janë morseta dhe bulloneri të ndryshme të gjitha këto të fundit të zinguar në të njëjtë. Me poshtë jepet një ide për realizimin e një sistemi të mbrojtjes kundër rrufeve dhe tokezimit në të janë treguar të gjithë elementet që duhet për të realizuar një sistem të tillë.



Sistemi klorit(Skema analoge)



Perbehet nga nje el/pompe klori me te dhena $Q=0.0025L/ore$ -5litra ore dhe presion 10 bar ne vartesi te presionit ku do te injektoj klor ka nje fuci 60 litra klor te lengwet me 14% tregetohet ne tregun e vendit dhe nje sistem tunash dhe rakorderish per lidhjen e pompes se klorit me rezervuarin e klorit dhe linjen e dergimit ne tubacionin kryesor.

PROJEKTUESI

Ing.Petrit PEQINI

